



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.118 dt.24.08.1998

PER
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN KORRIK 1998.

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe të vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin, projektvendimin, borderotë dhe proces verbalin e mbajtur nga Komisioni Ekonomik dhe I Përkrahjes Sociale me dt.17.08.1998 për dhënie të ndihmës ekonomike për muajin korrik 1998

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **9694 familje** gjithsej me një fond prej **30.405.404 lekë**. Për çdo njësi administrative si më poshtë :

Nj.A.	FAMILJE	FONDI	Nj.A.	FAMILJE	FONDI
1.	850	2.647.269	7.	717	2.264.378
2.	888	2.650.752	8.	676	2.086.666
3.	797	2.504.885	9	808	2.530.693

4.	1.220	3.885.931	10.	561	1.645.092
5.	1.103	3.486.906	11.	974	3.264.550
6.	1.100	3.438.282			
			Shuma	9.694	30.405.404

2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë (të dalin nga skema) **256 familje** sipas pasqyrave në relacion.
4. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike për mostërheqje lekësh brenda afatit : Agim Dulellari Nj.A.4, Kujtim Alliu, Hysen Lila, Nj.A.5, Fatbardha Tahiraj, Kozma Vjolla, Avni Hyseni, Pëllumb Lajthia, Xhevdet Lasku, Nj.A.7, Tereza Gjellaj, Nj.A.8, Avdulla Shehu, Nj.A.9, Shaqir Gjokola Nj.A.11.
5. Në pasqyrat e daljeve nga skema t'u shtohet në motivacion edhe fjala "arkëtuar lekët" : Skënder Berberi, Nj.A.2, Fatmir Taja, Gëzim Kuta, Pëllumb Muca, Nj.A.5, Alfred Hasimi, Albert Ducka, Ramiz Skënderi, Nj.A.9.
6. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **44 familje** sipas listës përkatëse në relacion.
7. Të trajtohen me ndihmë ekonomike në nivelin maksimal për familjet me 1 antar Lumturi Sulkaj, Nj.A.1, Krisanthi Cara, Nj.A.3.
8. Të trajtohen me ndihmë ekonomike si rast i veçantë Bedrie Cara familje me 7 anatarë Nj.A.1, Vasilika Papadhatos, familje me 1 antar Nj.A.5, Kume Mulleti, familje me 1 antar Nj.A.6.
9. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për paaftësi **1805 persona** me aftësi të kufizuar dhe **184 persona** për kujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar, gjithsej me një fond prej **8.209.190 lekë**.

- 10.** Pas përfundimit të shpërndarjes së lekëve të muajit qershor, të fillojë bërja e listë pagesave nga ekonomistët, administratorët shoqërorë nëqoftëse ka të pasqyrojnë në fletë të veçantë ndryshimet të cilat do të pasqyrohen në vendimin e Këshillit Bashkiak.
- 11.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Jashtme, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe ekonomistët e njësisë administrative.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI